<p>Administrimi i fondit pyjor/kullosor është tashmë një funksion i Bashkisë dhe realizohet bazuar në ligjin specifik mbi pyjet nr 57/2020 . Ky ligj ka hyrë në fuqi në dt 15 qershor 2020. Ky ligj në Nenin 16 pika 1. Përcakton edhe përgjegjësitë e NJQV në fushën e administrimit të Pyjeve duke përcaktuar se :</p> <p><u>Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki është strukturë e specializuar në nivel vendor, me attribute menaxhuese, kontrolluese/inspektuese, teknike dhe këshillimore, që administrojnë fondin pyjor kombëtar në pronësi, si dhe lëshon/pezullon/shfuqizon lejet për ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar për subjektet e interesuara.</u></p> <p>Pra me këtë ligj pranë Bashkive kalon përveç funksionit menaxhues edhe funksioni inspektues në fushën e Pyjeve. Në nenin 40 pika 3 Dispozitat kalimtare , detyrohen Bashkitë që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të krijojnë strukturën inspektuese nderkohe në pikën 4 të nenit 40 përcaktohet se është Agjencia organi që do të “ unifikojë praktikatat për kontrollin dhe procesin e inspektimit në fondin pyjor” .</p> <p>Kështu me Urdhërin e Ministrit të Mjedisit nr 254, datë 11.8.2023 “Për miratimin e përmbajtjes dhe modeleve të akteve për kundërvajtjet në pyje” është plotësuar baza ligjore për krijimin edhe të inspektoriatit pyjor.</p> <p>Mbrojtja dhe Administrimi i Pyjeve / Kullotave është veprimtari e Bashkisë Shkodër nëpërmjet Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Realizimi i shërbimit të Mbrojtjes së Pyjeve / kullotave bazohet në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet” si edhe në VKM nr. 1080/2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si edhe krijimin e njëjësive vullnetare të shuarjes së zjarreve”.</p> <p>Rritja natyrore e pyjeve shoqërohet me rritjen dhe zhvillimin e kurorës së drurëve e cila në 80-90% të saj është e pakrasitur. Kjo shoqërohet me rritjen dhe zhvillimin e shkurreve hijedashëse të cilat së bashku me kurorat e pakrasitura krijojnë një shtresë drunore gjysmë të njomë dhe gjysmë të thatë e cila përbën rrezik potencial për djegien nga zjarret e mundshme. Djegiet asnjëherë nuk kanë ardhur si zjarre të rastësishme por kanë qenë zjarrvënie të qëllimshme. Nisur edhe nga ndryshimet klimatike të cilat janë shoqëruar me rritje të temperaturave, por edhe me thatësi, mbrojtja e sipërfaqes pyjore/kullosore është një domosdoshmëri. Referuar Vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave ku shprehimisht janë të paraqitura detyrat: “Organizojnë sistemin e vrojtimit-sinjalizimit, i cili funksionon gjatë gjithë vitit në shkallë të ndryshme gatishmërie, në varësi të sezonit të zjarreve. Organizojnë, për shuarjen e zjarreve dhe eliminimin e pasojave të tyre, njësitë vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ), me 5–15 vullnetarë, të cilët veprojnë gjatë periudhës 1 maj – 15 tetor, për pyjet në pronësi të qeverisjes qendrore.</p> <p>Bashkia do të caktojë 10 punonjës/vrojtues me kontratë të përkohshme për një periudhë 5-mujore në zonat pyjore NjA Postribë, NjA Guri i Zi, NjA Pult, NjA Shalë etj. Pikërisht, këto janë zonat, të cilat kanë mundësinë më të madhe të rrezikshmërisë nga zjarret.</p>		
<p>1. Gjithashtu në zbatim të dispozitave të mësipërme për rastet e shuarje. Nisur nga rëndësia që ka mbikëqyrja, monitorimi e kontrolli i ekonomive pyjore dhe parcelave që administrohen nga Bashkia Shkodër, është e domosdoshme mbështetja logjistike me anë të mjetit të transportit që është në dispozicion të institucionit tonë duke e mbajtur në gjëndje pune.</p> <p>Thëksojmë se shtrirja territoriale e zonave pyjore është e gjërë dhe në zbatueshmëri të ligjit nr 57/2020 “Për Pyjet” i ndryshuar, këto zona monitorohen sipas planeve mujore të miratuara.</p> <p>Një tjetër element i rëndësishëm i punës sonë është edhe mbrojtja e pyjeve nga zjarret apo dëmtimet e tjera, e si nevojë për parandalim dhe sensibilizim janë vendosja e shenjave dalluese, tabelave të cilat vendosen në zonat pyjore kryesisht në vende të dukshme edhe nga kalimtarët.</p> <p>Sipas kërkesës, është parashikuar rivendosja e sinjalistikës pyjore si pjesë e masave të nevojshme për funksionimin e rregullt të këtij sektori.</p> <p>Gjithashtu, si çdo vit është e domosdoshme kryerja e aktiviteteve për muajin e pyllëzimit dhe sipas kërkesës bashkangjitur vlerësojmë se kjo rubrikë është pjesë e rëndësishme e punës së Administrimit dhe Inspektimit të pyjeve.</p> <p>s së zjarreve masive, nevojiten punonjës të përkohshëm, propozohet të jetë në dispozicion një fond për shërbimin e përkohshëm.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Nepërmjet këtij aktiviteti realizojmë shërbimin e inspektimit të pyjeve detyrim ligjor. • Nepërmjet këtij aktiviteti do të arrihet të mbrohet siperfaqja pyjore/kullosore nga zjarret të cilat në shumtën e rasteve janë zjarrvënie të qëllimshme. • Nepërmjet vrojtuesve arrihet të njoftohet në kohë për rastet e zjarreve dhe parandalohen këto zjarrvënie. • Njekohsisht planifikimi i punonjesve të përkohshëm është i nevojshëm që në rastet e zjarreve masive të jete mundësia që të merren punonjes shtese për shuarjen e këtyre zjarreve dhe shpëtimin e pyjeve/kullotave nga djegiet. • Një aspekt tjetër i mbrojtjes së pyjeve është edhe investimi për blerjen e një automjeti në funksion të këtij shërbimi.. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<p>1. Shërbimi i mbrojtjes së pyjeve/kullotave nga shkelesit si edhe mbrojtja e tyre nga zjarri nëpërmjet shërbimit të vrojtuesve prej 10 vrojtuesish. Ruajtja e fondit pyjor nga keqberesit dhe pajisja e specialisteve me arme.</p>		
b) Rezultatet që prisni		
<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve/ kullotave nga djegia. Zjarret janë një nga dëmtuesit kryesorë të pyjeve/kullotave. Nepërmjet këtij shërbimi do të arrijmë që të mbrojmë pyjet nga dëmtimi duke i konsideruar këto pyjet/kullotat si një pasuri të rëndësishme në shërbim të komunitetit të Shkodrës dhe me gjere. • Administrim me i mire dhe evidentim në kohë i problematikave në zone. 		
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt	
	Bashkia Shkodër	

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi pyjor/inspektoriati / vrojtues/ Paga dhe sigurime shoqërore	18,471	15,936	2,535			
A.2	Taksë automjeti	20			20		
A.3	Shërbimi i Mirëmbajtjes së automjetit	170			170		
A.4	Shërbim i sigurimit të mjetit	30			30		
A.5	FV Sinjalistikë pyjore	200			200		
A.6	Aktivite për muajin e pyllëzimit	80			80		
	Shuma	18,971	15,936	2,535	500		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi pyjor/inspektoriat/ vrojtues/ Paga dhe sigurime shoqërore	18,471	15,936	2,535			
A.2	Taksë automjeti	20			20		
A.3	Shërbimi i Mirëmbajtjes së automjetit	170			170		
A.4	Shërbim i sigurimit të mjetit	30			30		
A.5	FV Sinjalistikë pyjore	200			200		
A.6	Aktivite për muajin e pyllëzimit	80			80		
	Shuma	18,971	15,936	2,535	500		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi pyjor/inspektoriat/ vrojtues/ Paga dhe sigurime shoqërore	18,471	15,936	2,535			
A.2	Shpenzime operative	500			500		
	Shuma	18,971	15,936	2,535	500		
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2027, 2028, 2029		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Administrimit dhe Inspektimit të Pyjeve Institucion Likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr 4	P.AD141.Q1.O2.A1 Pastrim dhe sistemim kullote.	Programi AD141: Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit				
<ul style="list-style-type: none"> Përshkrimi i shkurtër i projektit : Pastrimi/përmirësimi i parcelave kullimore në NJ.A.. Kjo shërben për mbrojtjen e kullotes nga zjarri njëkohsisht lejon rigjenerimin natyror të saj. Në këtë mënyrë kullotat bëhen të shfrytëzueshme dhe ofrojnë një shërbim më të mirë në dobi të komuniteteve të zonave përreth tyre. Kjo rrit dhe fuqizon ekonominë familjare të banorëve të cilat kullotin bagetite në këto zona. 						
i. Situata						
<p>Në kuadër të mbrojtjes dhe ripërtëritjes së kullotave dhe shërbimit ndaj tyre, Bashkia Shkodër planifikon të kryejë punime të pastrimit/përmirësimit të parcelave në ekonominë kullimore. Të gjitha këto e kanë bërë objektin më të ekspozuar nga rreziku i djegieve nga zjarret e mundshme.</p> <p>Aktualisht Bashkia Shkodër ka nën administrim rreth 4,712 ha kullota. Të gjitha këto kullota janë të veshura me shtresë barishtore. Jo e gjithë sipërfaqja e tyre është e frytëshme (e përdorshme), arsyeja është sepse shumë sipërfaqe kullimore shtrihen në terrene shkëmbore. Sipas kësaj pikpamjeje, këto kullota klasifikohen në të dobishme dhe të padobishme.</p> <p>Gjendja e kullotave në përgjithësi nuk paraqitet e mirë, kapaciteti prodhues është nën nivelin dhe mundësitë që ka mjedisi ekologjik për të prodhuar. Të gjitha këto kullota kanë nevojë shumë të madhe për përmirësime rrënjësore dhe sezonale, me qëllim që të rritet kapaciteti mbajtës i tyre.</p> <p>"Trajtim i kullotave" janë operacionet teknike që kryhen në kullotat, të cilat kanë si qëllim shtimin e sipërfaqeve të dobishme, rritjen e kapaciteteve mbajtëse dhe vazhdimësinë e rigjenerimit natyror të tyre.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<p>a) ruajtjen dhe shtimin e vazhdueshëm të burimeve natyrore të kullotave e livadheve;</p> <p>b) ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe gjallërinë e ekosistemeve natyrore kullimore;</p> <p>c) përmirësimin dhe nxitjen e aftësive prodhuese të kullotave e livadheve;</p> <p>ç) ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të diversitetit biologjik të ekosistemeve kullimore;</p>						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> Percaktimi i zonës së ndërhyrjes nepermjet konsultimit me banorët dhe administratorët e NJA. Hartimi i projektit Zbatimi i projektit sipas fazave të parashikuara. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Qëllimi i përgjithshëm është mbrojtja e mjedisit natyror, Për më tepër, synon zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm. Me anë të përmirësimit arrihet ruajtja e objekteve të veshura me peme nga renia e zjarreve në pyje, pasi në pyjet halore zjarri është me evident në çdo kohë, si dhe stimulohet instalimi dhe ruajtja e filizise. 						
c) Aktoret e mundshme			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Komuniteti i zonave Shoqatat e pyjeve Shoqatat mjedisore			Bashkia Shkodër Shoqatat e pyjeve Shoqatat Mjedisore Vullnetare			
e) Shpenzimet e llogaritura për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pastrim dhe sistemim kullote në NJA	500			500	
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pastrim dhe sistemim kullote në NJA	500			500	
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pastrim dhe sistemim kullote në NJA	500			500	
Shuma		500			500	
d) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
Gjatë viteve 2027, 2028, 2029			Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme			
			Institucion Likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr 5	P.AD141.Q1.O2.A2: Rehabilitim sipërfaqe kullimore Ekonomia Pyjore/Kullimore	Programi AD141: Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit				
Pershkrimi i shkurter i projektit : Përmirësimi i parcelave kullimore në NJA. Kjo shërben për mbrojtjen e kullotës nga zjarri, njëkohësisht lejon rigjenerimin natyror të saj. Në këtë mënyrë kullotat bëhen të shfrytëzueshme dhe ofrojnë një shërbim më të mirë në dobi të komuniteteve të zonave përreth tyre. Kjo rrit dhe fuqizon ekonominë familjare të banorëve të cilët kullotin bagëtitë në këto zona.						
i. Situata						
Në kuadër të mbrojtjes dhe ripërtëritjes së kullotave dhe shërbimit ndaj tyre Bashkia Shkodër planifikon të kryejë punime të pastrimit/përmirësimit të parcelave në ekonominë kullimore..Te gjitha këto e kanë bërë objektin më të ekzpozuar nga rreziku i djegieve nga zjarret e mundëshme. Aktualisht Bashkia Shkodër ka nën administrim rreth 4712 ha kullota. Të gjitha këto kullota janë të veshura me shtresë barish tore. Jo e gjithë sipërfaqja e tyre është e frytëshme(e përdorshme), asyeja është sepse shumë sipërfaqe kullimore shtrihen në terrene shkëmbor e. Spas kësaj pikpamje këto kullota klasifikohen në të dobishme dhe të pa dobishme. Gjendja e Kullotave në përgjithësi nuk paraqitet e mirë, kapaciteti prodhues është në nivelin dhe mundësitë që ka mjedisi ekologjik për të prodhua. Të gjitha këto kullota kanë nevojë shumë të madhe për përmirësime rrënjëstore dhe sezonale, me qëllim që të rritet kapaciteti mbajtës i tyre. "Trajtim i kullotave" janë operacionet teknike, që kryhen në kullotat, që kanë si qëllim shtimin e sipërfaqeve të dobishme, rritjen e kapaciteteve mbajtëse dhe vazhdimësinë e rigjenerimit natyror të tyre.						
ii. Synimi i projektit						
Përmirësimin e mënyrave të mbarështimit të kullotave, në mënyrë të veçantë për parandalimin e gjërryerjes dhe të degradimit të tokës; nxitjen e shërbimeve të tjera social-ekonomike dhe sigurimin e përfitimeve të shumëfishta për shoqërinë ruajtjen dhe shtimin e vazhdueshëm të burimeve natyrore të kullotave e livadheve; ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe gjallërinë e ekosistemeve natyrore kullimore; përmirësimin dhe nxitjen e aftësive prodhuese të kullotave e livadheve; ç) ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të diversitetit biologjik të ekosistemeve kullimore;						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
1.Percaktimi i zones se nderhyrjes nepermjet konsultimit me banoret dhe administratoret e NJA. 2. Hartimi i projektit 3. Zbatimi i projektit sipas fazave të parashikuara.						
b) Rezultatet që prisi						
<ul style="list-style-type: none"> Qëllimi i përgjithshëm është mbrojtja e mjedisit natyror, Për më tepër, synon zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm. Me ane të përmirësimit arrihet ruajtja e objekteve të veshura me peme nga renia e zjarreve në pyje, pasi në pyjet halore zjarri është me evident në çdo kohe,si dhe stimulohet instalimi dhe ruajtja e filizerise. 						
c) Aktoret e mundshme			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Komuniteti i zonave Shoqatat e pyjeve Shoqatat mjedisore			Bashkia Shkodër Shoqatat e pyjeve Shoqatat Mjedisore Vullnetare			
e) Shpenzimet e llogaritura për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Rehabilitim sipërfaqe kullimore Ekonomia Pyjore/Kullimore.	500			500	
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Rehabilitim sipërfaqe kullimore Ekonomia Pyjore/Kullimore	500			500	
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Rehabilitim sipërfaqe kullimore Ekonomia Pyjore/Kullimore	500			500	
Shuma		500			500	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Gjatë viteve 2027, 2028, 2029		Drejtoria e Mjedisit dhe Energjise se Rinovueshme Institucion Likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr 6	P.AD141.Q1.O3.A1. Hartim plani i Menaxhimit të Pyjeve e Kullotave të Bashkisë Shkoder (Ekonomia Pyjore)	Programi AD141: Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi				
Pershkrimi i shkurtër i projektit: Menaxhimi i qendrueshëm i resurseve natyrore të pyjeve, kullotave dhe livadheve nënkupton mirëqeverisjen dhe përdorimin e resurseve në një mënyrë dhe me një ritëm që ruan dhe siguron biodiversitetin, prodhimtarinë, aftësinë ripërtëritëse, vitalitetin dhe potencialin e tyre për të përmbushur, për sot dhe të ardhmen, funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global. Plani i ri i mbarshimit të ekonomise pyjore përcakton hapat që do të ndiqen për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare, duke i hapur rrugë në këtë mënyrë investimeve në fondin pyjor dhe kullor nëpërmjet (a) pyllzimeve të reja dhe rehabilitimit të zonave të dëmtuara, (b) shfrytëzimit të qendrueshëm të pyjeve për nevojat publike, (c) rritjen e mundësive për mbrojtjen e shtresës së tokës nga gërryerjet/erozioni, (d) rritjen e prodhimit të lëndës drusore.						
i. Situata. "Plani i mbarshimit" është dokumenti bazë për mbarshimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjendjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme. Aktualisht për fondin pyjor kullor bashkiak nuk ka PMPK, ato plane që tre ish komuna kanë pasur (Pult, Shalë, Shosh) përveçse ju ka kaluar afati i përdorimit të tyre nuk janë të zbatueshme referuar dispozitave të Ligjit nr. 57/2020 "Për Pyjet". Për këtë arsye Bashkia planifikon që të realizojë PMPK për ekonominë pyjore në mënyrë që nëpërmjet zbatimit të tyre të përmirësojë fondin pyjor kullor.						
ii. Synimi i projektit :						
<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i planit të mbarrëshitrit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, siguron një ndërveprim me aktorët dhe bashkitë si dhe koordinim me institucionet qendrore nëpërmjet përdorimit të SISP dhe kjo pritet të ndodhë gjatë hartimit të PMPK dhe gjatë drejtimit të ndërhyrjeve dhe ngjarjeve në periudhën e vlefshmërisë së planit. Përdorimi i një metode të standartizuar të punës e përcaktuar në Udhëzuesin e Planeve të Mbarrëshitrit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, duhet të shërbejë për të siguruar rezultate homogjene dhe të krahasueshme në nivel lokal duke përdorur procedurat që ofrohen nga SISP. "Zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve" është procesi i administrimit dhe shfrytëzimit të pyjeve, në mënyra dhe intensitete të tilla që të ruajnë larinë e tyre biologjike, prodhimtarinë dhe kapacitetet ripërtëritëse, për të përmbushur tani dhe në të ardhmen funksionet ekologjike, ekonomike dhe shoqërore, pa shkaktuar dëme në ekosistemet e tjera, si në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe botëror. Hartimi i PMPK duhet të bëhet bazuar në parimin e mbarrëshitrit të qëndrueshëm që nënkupton "të ruajë dhe të forcojë gjendjen shëndetësore të ekosistemeve pyjore për një afat kohe të gjatë dhe në të njëjtën kohë për të siguruar mundësi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore për mirëqenien e brezave aktualë dhe atyre të ardhshëm". Ky plan hartohet për ekonominë pyjore që janë pjesë e Bashkive dhe natyrisht në koordinim edhe me njësitë e tjera ekonomike fqinje apo zonat e mbrojtura nëse është e nevojshme. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit .						
Vizitat në terren Hartimi i hartës paraprake dhe ndërtimi i rrjetit të sipërfaqeve provë Mjetet për punën e terrenit Puna në terren duhet të kryhet duke përdorur mjete elektronike si: GPS dhe tabletë për grumbullimin e informacionit në sipërfaqet provë. Planifikimi inventarizimit dhe përshkrimi i rrjetit të sipërfaqeve provë						
<ul style="list-style-type: none"> Metoda e inventarizimit dhe kampionimi për matjet e kullotave Futja e të dhënave dhe kontrolli Përshkrimi parcelar Të dhënat parcelare dhe lidhja me Kadastrën Pyjore dhe SISP 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Pyllzimi i sipërfaqeve të dëmtuara dhe shumë të dëmtuara. Mbrojtja e tokës nga gërryerjet Permiresimi i cilesisë së ajrit. Permiresim i situatës ekonomike të banorëve të zonave në vecanti. Projekti perfundimtar Plani i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave i perfutur , është një investim kapital i patrupezuar. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkoder Komuniteti i zonave/Pronaret/Shoqatat e pyjeve Shoqatat mjedisore				Bashkia Shkoder Ministria e Mjedisit e Turizmit Donatore FSHZH		
				Nga kjo:		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mije lekë)	Paga	Sigurime	Operative
A.1	Hartim plani i Menaxhimit të Pyjeve e Kullotave të bashkisë Shkoder .		4,000			4,000
Shuma			4,000			4,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mije lekë)	Nga kjo:		
				Paga	Sigurime	Operative
					Transfere	Kapitale

A.1	Hartim plani i Menaxhimit te Pyjeve e Kullotave te bashkise Shkoder .	4,000					4,000
	Shuma	4,000					4,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Investime per permiresim te fondit pyjor/kullosor.	4,000					4,000
	Shuma	4,000					4,000
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2027, 2028, 2029		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Mjedisit dhe Energjise se Rinovueshme Institucion Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr 7	P.AD141.Q1.O3.A2 Shpenzime për përmirësim të fondit pyjor/ kullosor.	Programi AD141: Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit				
<p>• Përshkrimi i shkurtër i projektit: Pastrimi/përmirësimi i parcelave pyjore në NJA. Pastrimi nëpërmjet prerjeve rigjeneruese apo të thata, pastrimi i sipërfaqeve nga degët dhe bimesi e thatë. Kjo shërben për mbrojtjen e pyllit nga zjarri, njëkohësisht lejon rigjenerimin natyror të tij.</p> <p>• Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në pyje. Në zona të ndryshme pyjore shfaqen dëmtues dhe sëmundje si kanceri i geshtenjes, hiri apo gjethpërdrësja. Sipas përcaktimit të zonës më të dëmtuar do të realizohet edhe projekti. Aktualisht Bashkia.</p> <p>• I gjithë ky fond pyjor kërkon edhe një sinjalistikë si informuese, por edhe orientuese e lajmëruese.</p>						
i. Situata						
<p>Në kuadër të mbrojtjes dhe ripërtëritjes së pyjeve dhe shërbimit ndaj tyre, Bashkia Shkodër planifikon të kryejë punime të pastrimit/përmirësimit të parcelave pyjore në ekonomitë pyjore. Pylli në zonën e propozuar ka dendësi të ndryshme, pavarësisht se mbjellja mund të jetë bërë me skemë afërsisht të rregullt. Kurora ka zhvillime të ndryshme dhe në një pjesë të konsiderueshme grumbulli pyjor (drurët përbërës) nuk janë vetë krasitë, apo degët e poshtme janë tharë por nuk janë shpëputur nga trugu i drurit. Gjithashtu, si pasojë e djegieve ndër vite, drurët e djegur për mungesë fondesh nuk janë hequr në pjesët ku grumbulli pyjor është me kurore dendësi më të ulët, që reziston dhe mbijeton; nën pylli është i përbërë nga lloje të ndryshme shkurreve etj. Të gjitha këto e kanë bërë objektin më të ekspozuar nga rreziku i djegieve nga zjarret e mundshme.</p> <p>Aktualisht, Bashkia Shkodër ka nën administrim rreth 48.000 ha pyje e kullota. I gjithë ky fond pyjor kërkon edhe një sinjalistikë si informuese, por edhe orientuese e lajmëruese. Aktualisht kjo sinjalistikë nuk ekziston, ose në disa raste është jashtë standardeve optimale (tabela të dëmtuara me shkrime të fshira).</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërrhyrje me rrallime në 10-15 % të numrit të druveve, duke hequr drurë të bigezuar, të thatë etj. • Krasitje të degeve të poshtme të pishave deri në 1/3 e kurores. • Prerja e shkurreve, ferrave të demshme dhe pastrimi i mbeturinave, grumbullimi i tyre në vende të caktuara (përrenj çeltira etj).Kjo detyrë do të kryhet krahas punimeve të krasitjes. • Përcaktimi i zonave ku do të vendoset sinjalistika. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> 4. Përcaktimi i zonës së ndërhyrjes nëpërmjet konsultimit me banorët dhe administratorët e NJA. 5. Hartimi i projektit 6. Zbatimi i projektit sipas fazave të parashikuara. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi i përgjithshëm është mbrojtja e mjedisit natyror, Për më tepër, synon zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm. • Me anë të përmirësimit (Rrallime+ Krasitje, pastrim shkurre) arrihet ruajtja e objekteve të veshura me pemë nga rena e zjarreve në pyje, pasi në pyjet halore zjarri është me evident në çdo kohë,si dhe stimulohet instalimi dhe ruajtja e filizerise. 						
c) Aktoret e mundshme			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Komuniteti i zonaveShoqatat e pyjeve Shoqatat mjedisore			Bashkia Shkodër Shoqatat e pyjeve Shoqatat Mjedisore Vullnetare			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për përmirësim të fondit pyjor/kullosor.	1,300			1,300	
Shuma		1,300			1,300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime për përmirësim të fondit pyjor/kullosor.	1,300			1,300	
Shuma		1,300			1,300	
		Total	Nga kjo:			

Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali (mije lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Pastrimi/përmiresimi i parcelave pyjore	1,300			1,300		
	Shuma	1,300			1,300		
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Gjatë viteve 2027, 2028, 2029		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Mjedisit dhe Energjise se Rinovueshme Institucion Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr.8- Rikonstruksion rrugë Shkodër Qendër
Kodi: P.AD141.Q2.O1.A1

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit të projektit	Bashkia e Shkodrës	Firma e propozuesit të Projektit	
Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit	Bashkia e Shkodrës		
Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori	Bashkia e Shkodrës	Vendodhja e Projektit	Bashkia Shkodër

02. Identifikimi i Idesë së Investimit

Projekt Idea	Bashkia Shkodër bazuar në dëgjuesat e organizuara për hartimin e PBA 2027-2029 me banorë të lagjeve ka vlerësuar teknikisht dhe sipas prioritetit gjendjen e rrugëve që kanë nevojë të qënësishme për përmirësim.	Viti 2027-2029
Proble met për tu adresuar	<p>Nisur nga shqetesimi i banorëve të lagjeve të qytetit, stafi i bashkisë Shkodër ka bërë të mundur verifikimin në terren rrugëve të evidentuara si problematike dhe që nuk është investuar asnjëherë. Verifikimi në terren është bërë kryesisht në rrugët, të cilat kanë të domosdoshme ndërhyrje në infrastrukturën nëntokësore si dhe shtresat rrugore, të cilat do shoqërohen me ndricim dhe sinjalistikë.</p> <p>Pas rikonjicionit në terren të këtyre rrugëve është konstatuar se shtresat rrugore janë tejet të dëmtuara, ose nuk ekzistojnë . Gjendja teknike e shtresave rrugore si dhe infrastruktura nëntokësore në këto rrugë është tejet e amortizuar, jashtë standartit dhe levizja e qytetarëve dhe e automjeteve bëhet me vështirësi.</p> <p>Nisur nga kjo situatë, parashikohet përmirësimi i dhe ndërtimi i shtresave asfaltike aty ku nuk ekzistojnë, të cilat konsiderohen të rëndësishme dhe me prioritet.</p> <p>Përshkrimi teknik i projektit dhe menyra e nderhyrjes: Ky projekt ka si qëllim të përmirësojë qarkullimin e qytetarëve dhe automjeteve, të përmirësojë shërbimet publike dhe të rrisë sigurinë e levizjes. Me ane të kesaj nderhyrje rritet qendrueshmeria e rruges per nje periudhe me afatgjate, kundrejt nje kostoje relativisht te ulet.</p> <p>Për përmirësimin e shtresave rrugore parashikohet të ndërhyhet në disa kategori punimi, sipas profilave tip të përshkruar si më poshte:</p> <ol style="list-style-type: none"> Profilu Tip. "A" (Parashikohet në rastet kur mungon shtresat e rruges, komplet infrastruktura nëntokësore ose është e amortizuar si dhe ndricimi) <ul style="list-style-type: none"> Ndërtim rrjeti KUB. Ndërtim rrjeti KUZ. Ndërtim rrjeti ujësjellësi. Shtrese çakellit=15/20cm Shtrese stabilzanti t=10cm Shtrese binderi t=4cm ose 5cm(sipas rastiit te kategorise se rruges qe do te nderhyhet) Shtrese asfaltobetoni t=3cm ose 4cm(sipas rastiit te kategorise se rruges qe do te nderhyhet) Trotuar. Ndricimi. Profilu Tip. "B" (Parashikohet, sipas rastiit, ku njëra apo disa nga komponentët e infrastrukturës nëntokësore apo ndricimi ekzistojnë. shtresa asfaltike ekzistuese ka plasartije dhe çarje deri ne kuoten e shtreses se stabilizantit dhe kur ka cedimet jane te vogla. Demtimet mund te jene kryesisht ne njeran ane d.m.th. majtas ose djathtas ose ne dy anet njekohesisht ose ne disa raste ne te gjithë gjeresine e rruges): <ul style="list-style-type: none"> Ndërtim rrjeti KUB. Shtrese çakellit=15/20cm Shtrese stabilzanti t=10cm Shtrese binderi t=4cm ose 5cm(sipas rastiit te kategorise se rruges qe do te nderhyhet) Shtrese asfaltobetoni t=3cm ose 4cm(sipas rastiit te kategorise se rruges qe do te nderhyhet) Trotuar. <p>Përveç ndërhyrjeve për riparimin e shtresave rrugore, ky projekt parashikon gjithashtu edhe disa ndërhyrje të vogla për realizimin e kullimit të ujërave në zonat e banura dhe segmentet që kanë pjerrësi të madhe gjatësore. Këto punime parashikohen të ndërtohen me beton C20/25 dhe konkretisht për ndërtimin e kunetave + bordurave, veshjeve me beton të kanaleve, mure të vogla kufizuese etj.</p> <p>Ky projekt parashikon edhe germimin për pastrimin dhe ribërjen sipas rastiit të kanaleve anësore kulluese dhe realizimin e bankinave.</p> <p>Në tabelën e mëposhtme janë zërat e punime që parashikohen për nderhyrjet:</p>	
	PUNIME PER NDERTIMIN E RRUGES	
3.89/b	Germim dheu me eskavator goma 0.25m3, ne kanale gjeresi >2m, toke zakonshme kategoria III, me shk ne mjet	

3.An.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (Mbushje e rruges)
3.An.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (Shtresa e rruges 2x15cm)
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm
3.233/2	Shtrese binderi me granil me gur kave.5cm,me makineri
3.224/1	Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri
3.620	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka

3.243/1	Struktura monolite te holla betoni C16/20(kuneta)
3.183/c	Shtrese zhavor lumi t=20cm
3.618	F V bordura betoni 15x25cm
	PUNIME PER KANALIZIMET E UJRAVE TE BARDHA DHE TE ZEZA
3.379	Ndertim drenazhi, mbushje me rere natyrale(Rere nen dhe mbi tubacione PE + kompakesim)
3.378	Ndertim drenazhi, mbushje me zhavor prodhuar mak(Zhavorr ne kanale)
3.An/1t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm
An-23	Pusete b/a shiu 40 x 60 cm, h = 100 cm, me kapak gize
An-20	Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 150 cm
3.139	Germim dheu me ekskavator goma 0.35-0.40 m³, ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke
An-M3	Skarifikim shtrese asfalti me makineri
	PUNIME PER UJESJELLESIN
3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke
3.379	Ndertim drenazhi, mbushje me rere natyrale(Rere nen dhe mbi tubacione PE + kompakesim)
3.378	Ndertim drenazhi, mbushje me zhavor prodhuar mak(Zhavorr ne kanale)
2.491/b	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20-25mm, PN 16
2.491/f	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, PN 16
2.575	Puse kontrolli 1x1x1.5m
	PUNIME NDRICIMI DHE TEKNOLOGJIKE
3. An/53	FV shtylla metalike per ndricim, H=7m d=160mm
An.6	FV ndricues rrugor Led ,1800lm, 4000 K
3.An/ksh	FV krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10."
3.An/57b	F.V Pusete elektike kontrolli PVC,p/f 40x40x40 cm
3.An/et	FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm
An-(M3)	F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement
An.7	F.V. Tuba metalik D=110mm
An.8	F.V. Kabell FG16 0.6/ 1KV. 4x 6mm2
3.654/1	Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 80
3.379	Ndertim drenazhi, mbushje me rere natyrale(Rere nen dhe mbi tubacione + kompakesim)
2.a-93	Percjelles tokezimi bakri , Cu, S=35mm2 i zhveshur
3.An/pp	FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086(per rrjetin teknologjik)
2.519	Tub kanalizimi pvc ø 90 mm (per rrjetin elektrik dhe teknologjik)
	PUNIME PER SINJALISTIKEN
An151	Boje bikomponente
An99	Tabela sinjalizimi

Për zbatimin e sistemit të pikëzimit për renditjen e përparësive në investimet rrugore, theksojmë se fokusi duhet të jetë tek realizimi i projekteve të plota me kanalizime ujëra të zeza, të bardha, ndriçim, dhe shtresa asfaltike. Në rastet kur sistemi i pikëzimit i rëndit në fund, rrugët e vogla (me gjatësi të vogël) të vlerësohen në grup, pra si një ndërhyrje rehabilituese për zonën, dhe të ndërhyhet njëherazi në të gjitha rrugët dytësore të një zone të caktuar. Në këtë rast me kriteret e vlerësimit të sistemit të propozuar të vlerësohet zona.

Investimet në secilën njësi/fshat, do të realizohen në radhë sipas lagjeve apo njërive/fshatrave, sipas angazhimit të familjeve për pagesën e detyrimeve vendore. Administratorët, kryetaret e fshatrave kanë rolin e vlerësimit dhe angazhimit të komunitetit për përmbushjen e detyrimeve ligjore

03. Kostot e Projektit të Investimit

	Totali	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Kosto e zbatimit				
Kosto supervizim				
Kosto kolaudim				
Kosto e projektimit				
Kosto Totale e Projektit - 000/lekë	574,492	170,508	158,071	245,913

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				
Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)				
Sekretari i Përgjithshëm				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (nqs ka)				

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit të projektit	Bashkia e Shkodrës	Firma e propozuesit të Projektit	
Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit	Bashkia e Shkodrës		
Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori	Bashkia e Shkodrës	Vendodhja e Projektit	Bashkia Shkodër

02. Identifikimi i Idesë së Investimit

Proje kt Idea	Bashkia Shkodër bazuar në dëgjesat e organizuara për hartimin e PBA 2027-2029 me banorë të lagjeve ka vlerësuar teknikisht dhe sipas prioritetit gjenden e rrugëve që kanë nevojë të qënësishme për përmirësim.	Viti 2027-2029
